



BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 22/10/1 Prot

Rrëshen më, 10 . 08 . 2024

V E N D I M

Nr. 53 datë 03. 06. 2024

PËR

“MIRATIMIN E KONTRATËS SË DHURIMIT NDËRMJET; SHOQËRISË KONÇESIONARE “SEKA HYDROPOWER” SHPK DHE BASHKISË MIRDITË, PËRFAQËSUAR NGA KRYETARI Z. ALBERT MËLYSHI”.

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, neni 34, neni 54, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, ligji nr. 9936 datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Kodi Civil në Republikën e Shqipërisë i përditësuar, neni 761 e vijues, në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, në Kontratën e Dhurimit me objekt: “Mirëmbajtjen e rrugëve rurale me fuqi punëtore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, pas diskutimeve në mbledhjen e këshillit bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë Kontratën e Dhurimit ndërmjet: Shoqërisë Konçesionare “Seka Hydropower” shpk dhe bashkisë Mirditë, përfaqësuar nga Kryetari Z. Albert MËLYSHI, me objekt: “Mirëmbajtjen e rrugëve rurale me fuqi punëtore”, (*bashkëlidhur Kontrata e Dhurimit, pjesë përbërëse e këtij vendimi*).
2. Shuma në vlerë e kësaj Kontrate Dhurimi është; **1 200 000 (një milion e dyqind mijë)** lekë në vit, me afat 3 (tre) vjeçar.
3. Kjo vlerë do të arkëtohet në llogarinë e bashkisë Mirditë, si e ardhur jashtë limitit, për bashkinë Mirditë, në kapitullin 06.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i bashkisë Mirditë, (drejtoria e zhvillimit ekonomik, tatim taksa dhe drejtoria juridike).

Ky vendim, hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al



KRYETAR

Aleksandër PICAKU

ADRESA: SHESH “ABAT DOCI”, RRESHEN

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al



BASHKIA MIRDITË

G.T
SHOQËRIA KONÇESIONARE
SEKA HYDROPOWER SH.P.K

Nr. 2343 Prot,
Rreshen, më 10 / 06 2024

Nr. _____ Prot
Burrel më _____ / _____ / 2024

KONTRATË DHURIMI

E lidhur në Rreshen, sot më 06 / 06 / 2024, midis palëve:

DHURUES:

Shoqëria Konçesionare SEKA HYDROPOWER Sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e së drejtës shqiptare, me NIPT L32116020A, me seli në adresën: Diber Rukaj BRUC Rruga Prell Energy, godine 2 kateshe, Lagjia Neziraj, Fshati Bruç, Burrel, Bashkia Mat, Shqipëri, me Administrator Z.Sokol Muceku.

Dhe

PËRFITUES: Bashkia Mirdite, e identifikuar me NIPT K39004005W, me adresë: Sheshi "Abat DOÇI", 4601, Rreshen, Mirdite, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Albert Mëlyshi,

Sa me sipër:

Palët bien dakord për lidhjen e kësaj kontrate si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate është sigurimi i fondeve të nevojshme nga shoqëria konçesionare për mirëmbajtjen e vazhdueshme të rrugëve rurale me fuqi punëtore në fshatrat ku subjekti ushtron aktivitetin, mirëmbajtje e cila do të realizohet nëpërmjet strukturave të Bashkisë Mirditë.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo kontratë bazohet në nenin 9, pika 1.6, shkronja "a" dhe nenin 64, shkronjat "a" dhe "gj", të ligjit nr. 139/2015 për "Vetëqeverisjen vendore"; nenet 761-771, të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), ligjin nr. 7892, datë 21.12.1994 për "Sponsorizimet", i ndryshuar.

Neni 3

Detyrimet e palëve kontraktuese

3.1. Dhuruesi merr përsipër:

- a. Të garantojë fondet e nevojshme për mirëmbajtjen e rrugëve rurale të fshatrave të Bashkisë Mirditë në vlerën 1 200 000 (një milion e dyqind mijë) lekë, në vit.
- b. Pagesa do të kryhet përkundrejt faturës respektive tatimore që do të lëshohet nga Bashkia.
- c. Vlera e paguar sipas faturës së parashikuar më sipër do të jetë e vetmja shumë e pagueshme nga Shoqëria Koncesionare dhe të gjitha taksat përkatëse, nëse ka të tilla, janë të përfshira në këtë shumë.

3.2. Përfituesi merr përsipër:

- a. Që me mjetet e veta dhe duke marrë përsipër riskun të realizojë mirëmbajtjen e vazhdueshme të rrugëve rurale të fshatrave ku subjekti ushtron aktivitetin, mirëmbajtje të cilat do të realizohen nëpërmjet strukturave të veta të Bashkisë.
- b. Të hartojë e miratojë grafikun e mirëmbajtjeve të zakonshme dhe të mbajë në gadishmëri mjete dhe burime për të garantuar mirëmbajtjet që do të nevojiten të kryhen në raste të jashtëzakonshme sipas nevojave që do të dalin në terren herë pas here.

Neni 4

Afat i kontratës

Kjo kontratë lidhet për një afat të caktuar 3 (tre) vjeçar nga data 06.06.2024 deri më datë 31.05.2027.

Neni 5

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet dhuruesit dhe përfituesit zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt palët drejtohen për zgjidhjen e tyre në Gjykatën kompetente.

Neni 6

Njoftimet

Të gjitha njoftimet dhe komunikimet midis palëve në këtë kontratë bëhen me shkrim duke i'u dorëzuar personalisht personave të kontaktit, si më poshtë vijon:

a) Për Përfituesin: Bashkia Mirdite

- Adresa: Sheshi "Abat Doci", 4601, Rreshen.
- E-mail: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

b) Për Dhuruesin:

- Shoqëria Koncesionare SEKA HYDROPOWER Sh.p.k., me NIPT L32116020A, me seli në adresën: Diber Rukaj BRUC Rruga Prell Energy, godine 2 kateshe, Lagjia Neziraj, Fshati Bruç, Burrel, Bashkia Mat, Shqipëri, me Administrator Z.Sokol Muceku.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Kjo kontratë dhurimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët.

Neni 8

Dispozita të fundit

9.1 Palët përgjigjen reciprokisht për respektimin e kësaj kontrate.

9.2 Kjo kontratë përbën marrëveshjen e plotë mes palëve. Çdo shtesë apo ndryshim i kësaj kontrate bëhet vetëm në formë të shkruar.

9.3 Kjo kontratë hartohet në 3 (tre) kopje, nga 1 (nje) kopje origjinale për shoqërinë, dhe 2 (dy) kopje për Bashkinë Mirditë, të cilat pasi bien dakord e nënshkruajnë atë rregullisht.

Kushtet e mësipërme aprovohen dhe firmosen në emër të palëve kontraktuese:

Koncp:M.Topollaj
Konf:B.Dedaj

PALËT KONTRAKTORE

PËRFITUESI
BASHKIA MIRDITË
KRYETARI
Albert MËLYSHI



DHURUESI
SHOQËRIA KONÇESIONARE
SEKA HYDROPOWER SH.P.K

Administratori
Sokol MUCEKU

